



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RTK 1  
Mentor SHALA  
Drejtor  
Prishtinë

Ankesa Nr. 2016/200 KPM vs RTK 1  
Ref:1610/1047/KPM/am

### VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2016/200 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër RTK 1 (“Pala Përgjegjëse”)**

---

#### Faktet

1. Subjekti transmetues publik RTK 1 është televizion publik me seli në Prishtinë. RTK 1 është pajisur me licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës, obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së, dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM, me datën 27 qershor 2016, ka pranuar një ankesë nga z. Agron Demi (Palë Ankuese) ndaj Palës Përgjegjëse, për një kronikë të transmetuar në edicionin e lajmeve të orës 19:30 në datën 24 qershor 2016, përmes së cilës Pala Ankuese pretendon se: *“Radio Televizioni i Kosovës (RTK) më ka përfshirë në njërin nga kronikat e saj, duke mos më kontaktuar për të marrë qëndrimin tim, si dhe duke shtrembëruar një deklaratë timen në rrjetin social Facebook... Në tërësi, kronika e lajmeve ka për synim denigrimin tim dhe është sulm në punën time dhe organizatës në të cilën punoj”*.
3. KPM, me datën 28 qershor 2016, nëpërmes një shkrese e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda pesë ditësh të ofrojë një sqarim lidhur me të.
4. KPM, me datën 30 qershor 2016, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës pretendon se *“Pala Përgjegjëse në asnjë mënyrë nuk ka shtrembëruar asnjë fakt dhe asnjë të dhënë, dhe me këtë rast Pala Përgjegjëse ka kryer punën e vet si transmetues publik, duke paraqitur deklaratimet e ndryshme publike për dy raste të ngjashme që kanë ndodhur së fundmi në Kosovë.*

5. KPM, ka analizuar ankesën e Palës Ankuese dhe përgjigjen e Palës Përgjegjëse, dhe ka bërë monitorimin e kronikës ndaj së cilës është bërë ankesa dhe në bazë të raportit të monitorimit të datës 1 korrik 2016, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2 të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, duke gjetur se kronika në fjalë ka pasur qëllim të keq, kritikizëm të padrejtë apo sulm ndaj Palës Ankuese.
6. KPM, pas të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 11 korrik 2016 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke kërkuar nga Pala Përgjegjëse t'i ofrojë Palës Ankuese të drejtën për demant në afat prej shtatë ditësh, në pajtim me nenin 12 të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01.
7. KPM, pas Njoftimit për Shkelje, me datën 28 korrik 2016, ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse, në të cilën sërish i kundërshton shkeljet e gjetura nga KPM, duke mos i quajtur si të tilla dhe duke mos ia dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese, sipas kërkesës së KPM-së.

### Analiza Ligjore

8. Komisioni i Pavarur për Media bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2 dhe nenin 12, paragrafi 3, të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audiovizuale në Republikën e Kosovës KKPM-2010/01 i cili përcakton se:

Neni 6, paragrafi 2, i Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, përcakton se:

*“Programet që kanë qëllim të keq, kritikizëm të padrejtë apo sulm në një person, fizik apo juridik, janë të ndaluara.”*

Neni 12, paragrafi 3, i Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, përcakton se:

*“Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet të ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë të njëjtë.”*

9. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2 dhe nenin 12, paragrafi 3, të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, duke mos i dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese.
10. Komisioni i KPM-së, duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshme për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 6, paragrafi 2 dhe nenin 12, paragrafi 3, të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, duke mos i dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese.
11. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni i KPM-së vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 12, paragrafi 3, të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, duke mos i dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese.

## Vendimi


12. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 12, paragrafi 3, të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01, duke mos i dhënë të drejtën e demantit Palës Ankuese.
13. Komisioni, bazuar në nenin 30 paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, merr vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me *Vërejtje* për shkelje të nenit 6, paragrafi 2 dhe nenit 12, paragrafi 3, të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01.
14. Në rast se Pala Përgjegjëse pas pranimit të këtij Vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Kodin e Sjelljes KKPM-2010/01 dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, Komisioni do të ndërmarr masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

## E drejta për Ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

## Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media



11.10.2016

datë